



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni Pranveror

Kryesia e Kuvendit

P-021
Prishtinë, më 5 mars 2018, në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 5 MARS 2018

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, Kujtim Shala, Slavko Simiq dhe Mufera Shinik, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Albulena Haxhiu, Avdullah Hoti, Elmi Reçica, Ahmet Isufi, Bilall Sherifi dhe Albert Kinolli.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Avni Bytyqi dhe Valmir Klaiqi.

Nga Administrata e Kuvendit: Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj, Musli Krasniqi dhe Osman Shatri.

Nga EUSR-ja: Blerta Bejtullahu,

Nga OSBE-ja: Sanije Berisha,

Nga NDI-ja: Shefki Kastrati.

Mbledhjen e kryesoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë rend të ditës:

1. Shqyrtimi i kërkesës së deputetëve Avdullah Hoti dhe Arbërie Nagavci, të mbështetur edhe nga 38 deputetë nënshkrues, për seancë të jashtëzakonshme

Kryetari i njoftoi të pranishmit me kërkesën e deputetëve Avdullah Hoti dhe Arbërie Nagavci, të mbështetur edhe nga 38 deputetë nënshkrues, për seancë të jashtëzakonshme të Kuvendit, më 6 mars 2018, në orën 10:00, me këtë rend dite:

1. Debat parlamentar lidhur me “Vendimin e Regjistrimit Evropian të Sigurimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë për përjashtimin e Agjencisë Kosovare të Akreditimit nga ky organizëm, datë 27 shkurt 2018”.

Në lidhje me kërkesën e lartcekur për seancë të jashtëzakonshme diskutuan: Bilall Sherifi, në emër të GP “Nisma për Kosovën”; Avdullah Hoti, në emër të GP të LDK-së dhe Ahmet Isufi, në emër të GP të AAK-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, pas diskutimeve, me pëlqimin e propozuesit për seancë të jashtëzakonshme, vendosi që seanca e jashtëzakonshme e Kuvendit, sipas kërkesës së deputetëve Avdullah Hoti dhe Arbërie Nagavci, të mbështetur edhe nga 38 deputetë nënshkrues, të mbahet më 7 mars 2018, në orën 11:00, me këtë:

Rend dite

Debat parlamentar lidhur me “Vendimin e Regjistrimit Evropian të Sigurimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë për përjashtimin e Agjencisë Kosovare të Akreditimit nga ky organizëm, datë 27 shkurt 2018”.

* * *

2. Të ndryshme:

Në vazhdim, Kryesia i shqyrtoi edhe katër pika të tjera, si në vijim:

1. Kërkesa e deputetes Albulena Haxhiu, e mbështetur edhe nga 10 deputetë nënshkrues të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”

Kryetari i njoftoi të pranishmit me kërkesën e deputetes Albulena Haxhiu, e mbështetur edhe nga 10 deputetë nënshkrues të Grupit Parlamentar të LVV-së, për debat parlamentar më 8 mars 2018, sipas kërkesës së deputetes Fatmire Kollçaku, e mbështetur edhe nga 8 deputetë nënshkrues, në lidhje me dhunën në familje dhe adresimin institucional.

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, vendosi që Kuvendi të mbajë seancë plenare më 8 mars 2018, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. Debat parlamentare lidhur me dhunën në familje dhe adresimin institucional.

2. Projekt-Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Kosovës

Kryetari i njoftoi të pranishmit se Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 27 shkurt 2018, e ka autorizuar kryetarin e Kuvendit që lidhur me rekomandimin e Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit që në afatin prej dhjetë (10) ditëve ta thërrasë një takim të përbashkët të Kryesisë së Kuvendit me kryetarët e grupeve parlamentare për të diskutuar lidhur me Projekt-Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe për harmonizimin e qëndrimeve, para procedimit për shqyrtim të parë në seancë plenare.

Lidhur me Projekt-Rregulloren diskutuan: kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli; Albulena Haxhiu, në emër të GP të LVV-së, dhe Avdullah Hoti, në emër të GP të LDK-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, Kryesia vendosi që më 8 mars 2018, në orën 12:00, Kryesia e Kuvendit të takohet edhe një herë me kryetarët e grupeve parlamentare për të diskutuar lidhur me Projekt-Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe për harmonizimin e qëndrimeve para procedimit për shqyrtim të parë në seancë plenare.

3. Kërkesa e OJQ-së “Green Art Center - Prishtina” për mbështetje financiare

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

VENDIM

1. OJQ-ja, “Green Art Center - Prishtina” mbështetet financiarisht në shumën prej 2 500 (dymijë e pesëqind) euro për mbështetjen e fushatës “You are a Sunflower Organisation”.

2. Mjetet e parapara në pikën një (1) të këtij vendimi ndahen nga kategoria ekonomike: subvencione dhe transfere, dhe transferohen në xhironlogarinë bankare të OJQ-së “Green Art Center - Prishtina”, me numër 1501090003990459, në bankën Rariffeisen Bank.

4. Kërkesa e shoqatës Down Sindrom Kosova - Dega në Prizren, për mbështetje financiare

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e shoqatës Down Sindrom Kosova - Dega në Prizren, vendosi që ta mbështesë atë në shumën prej 1 500 (njëmijë e pesëqind) euro për realizimin e aktiviteteve të tyre.

Në fund, deputetja Albulena Haxhiu e shtroi çështjen e punëtorëve të mirëmbajtjes së hapësirave të Kuvendit të Kosovës, diskutimi i të cilës është dhënë në transkript.

Kryetari kërkoi nga Administrata e Kuvendit që lidhur me çështjen e shtruar nga znj. Haxhiu ta përgatisë një informatë për Kryesinë e Kuvendit.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 13:35 minuta.

Kryetari i Kuvendit:

Kadri Veseli

Procesverbalin e hartoi:

Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale